



MASSACHUSETTS COVID-19 VACCINE PROGRAM

Mënyra për ta rritur vaksinimin kundër COVID-19

10 shtator 2021

- **Kërkoni një klinikë ambulatore falas për COVID-19**
[Klinika ambulatore falas në seli](#) dhe shërbime falas vaksinimi ofrohen për punëdhënësit, shkollat, organizatat komunitare dhe fetare dhe grupe të tjera. Ju veç duhet të siguroni hapësirën e duhur.
- **Gjeni një klinikë**



Vizitoni [VaxFinder.mass.gov](https://vaxfinder.mass.gov) për të lokalizuar një nga 900 pikat e vaksinimit anembanë Commonwealth-it.

- **Vaksinohuni në shtëpi**

Telefononi te Linja e [vaksinim në shtëpi](#) në Shtëpi në 833-983-0485 për të planëzuar një [vaksinim në shtëpi](#) falas.

- **Ftoni një ekspert që t'u përgjigjet pyetjeve në një takim**

Dërgoni email te VaccineEquityInitiative@mass.gov për të kërkuar të lidheni me një ekspert klinik (p.sh. mjek infeksionist, alergolog dhe/ose të shëndetit të nënës) ose plotësoni [këtë formular](#) për të ftuar një ambasador të vaksinës nga DPH (profesionist i shëndetit publik me përvojë për marrëdhëniet në komunitet).



- **Bashkëndani materiale edukative dhe informative**

Përdorni [video, broshura dhe grafikë](#), që ju ofrohen në 10 gjuhë, për të rritur besimin e njerëzve te siguria dhe efikasiteti i vaksinës.

- **Merrni ndihmë për transportin dhe më shumë**

Ofrohen shërbime dhe ndihmë, përfshi për transportin vajtje-ardhje në takimet, shërbime përkthimi, ndihmë me mobilitetin dhe më shumë. Dërgoni email te VaccineEquityInitiative@mass.gov për më shumë informacion.



- **Leje mjekësore e paguar për vaksinimin**

[Programi i Përkohshëm i Lejeve Mjekësore me Pagesë gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme të COVID-19](#) u kërkon punëdhënësve të vënë në dispozicion të punonjësve të tyre në Massachusetts ditë lejesh me pagesë për sëmundje të ndërlidhura me COVID-in, për karantinën

dhe vaksinimin përkatës, për çfarë mund të aplikojnë pastaj për rimbursim nga shteti. [Kredite taksash federale](#) gjithashtu janë në dispozicion për biznese të vogla dhe të mesme, që u ofrojnë punonjësve të tyre leje të paguar mjekësore dhe familjare. Mësoni më shumë te [treasury.gov](#).

Punonjësit: merrni informacion për lejen mjekësore të paguar, në vendin tuaj të punës.

- **Mësoni më tej:** www.mass.gov/COVIDVaccine